

DEKRET
Nr.1707, datë 22.1.1997

PËR TATIMIN MBI BIZNESIN E VOGËL

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

DEKRETOJ:

Neni 1

Gjithë personat fizikë a juridikë, vendas ose të huaj që nuk janë subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar, i nënshtrohen tatimit mbi biznesin e vogël, i cili llogaritet me tarifa proporcionale mbi xhiron.

Neni 2

Tarifat proporcionale, sipas ligjit të veprimtarisë së biznesit të vogël, janë:

- a) Tregtarët me pakicë që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në dyqane ose në njësi të tjera të veçanta 5 për qind.
- b) Artizanët dhe personat e tjerë që kryejnë shërbime publike në dyqane ose njësi të tjera të veçanta, traktoristët, kombanierët, zëtoristët etj. që kryejnë shërbime bujqësore transporti etj. 3 për qind.
- c) Specialistët, si inxhinierët, mësuesit, veterinerët, financierët, agronomët etj. të kësaj natyre, që veprimtarinë e tyre e kryejnë në mënyrë të pavarur, 3 për qind.
- ç) Avokatët, mjekët e stomatologët, 8 për qind.
- d) Subjektet që organizojnë kurse të ndryshme për patenta, që përdorin salla lojërash etj. të ngjashme me to, 10 për qind.
- dh) Të gjitha mjetet e lundrimit ujor që përdoren për transport pasagjerësh e mallrash, 5 për qind.
- e) Të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese të pavarur, të tilla si furra gëlqereje, prodhim tjegullash etj. Të kësaj natyre (përfshirë prodhimet e karakterit të ushqimit social), 3 për qind.
- ë) Çdo veprimtari tjetër e pavarur fitimprurëse që ushtrohet në dyqane ose në njësi të tjera të veçanta e përmendur në pikat e mësipërme të këtij neni, 5 për qind.
- f) Subjektet që kryejnë riparime e shërbime në lokale të veçanta për artikuj elektroshtëpiakë, 5 për qind.
- g) Subjektet që bëjnë tregti me shumicë të cdo lloji, 6 për qind.
- gj) Subjektet që ushtrojnë veprimtari në transportin e udhëtarëve brenda rrethit, 4 për qind dhe jashtë rrethit, 5 për qind.
- h) Subjektet që ushtrojnë veprimtari në transportin e mallrave, 5 për qind.

Neni 3

Këshilli i Ministrave ka autoritetin të caktojë tatime minimale të detyrueshme për t'u paguar nga subjektet, duke u nisur nga vendndodhja, veprimtaria, indeksi mesatar vjetor i inflacionit, si dhe në rastet e pamundësisë së matjes të xhiros të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në formë ambulante etj.

Neni 4

Tatimi vjetor llogaritet dhe caktohet nga organet tatimore të rretheve brenda muajit janar për çdo vit tatimor, duke u mbështetur në deklaratën vjetore parashikuese të bërë nga tatimpaguesi dhe verifikimet e bëra nga punonjësit e organeve tatimore.

Neni 5

Tatimi mbi biznesin e vogël derdhet në 4 këste në afatet 1-31 mars,1-30 qershor,1-30 shtator dhe 1-30 nëntor të çdo viti.

Neni 6

Subjektet e këtij ligji janë të detyruara të regjistrojnë, dokumentojnë e deklarojnë me shkrim xhiron e realizuar. Deklarata vjetore për xhiron e realizuar u jepet organeve tatimore brenda datës 15 janar të vitit pasardhës, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Financave.

Neni 7

Ligji nr.7679, datë 3.3.1993 "Për tatimin mbi biznesin e vogël", shfuqizohet.

Neni 8

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKES
Sali Berisha